

STATISTIKAT E KARAKTERISTIKAVE TË MJETEVE RRUGORE

Viti 2025

Në fund të vitit 2025, numri i mjeteve rrugore të regjistruara (me status aktiv ose të çregjistruara përkohësisht) arriti në 1.048.092 mjete, duke shënuar një rritje prej 9,3 %, krahasuar me vitin 2024.

- Autoveturat përbëjnë 80,8 % të totalit të mjeteve rrugore.
- Numri i autoveturave për 1.000 banorë u rrit në 361, nga 326 në vitin 2024.

Mjetet sipas qarqeve

- Qarku i Tiranës ka numrin më të madh të mjeteve rrugore, duke përbërë 34,7 % të totalit, i ndjekur nga Durrësi (13,6 %) dhe Fieri (9,1 %).
- Qarku i Durrësit ka nivelin më të lartë të motorizimit në vend, me 535 autovetura për 1.000 banorë.

Karakteristikat teknike të mjeteve


- Mjetet meambio manuale përbëjnë 55,9 % të totalit të mjeteve rrugore.
- Mjetet e prodhuara gjatë periudhës 2000–2010 përbëjnë 55,3 % të totalit të mjeteve rrugore.
- Autoveturat me moshë 11–20 vjet përbëjnë 45,7 % të autoveturave gjithsej.

Markat më të përhapura

- Marka Volkswagen është më e përhapura ndër autoveturat në vend, me 19,7 % të totalit, e ndjekur nga Mercedes-Benz me 18,1 %.

Lënda djegëse dhe elektrifikimi

- Nafta mbetet lënda djegëse dominuese për autoveturat në vitin 2025, duke përbërë 72,1 % të totalit.
- Numri i autoveturave elektrike u rrit me 91,2 %, krahasuar me vitin 2024.

FIG.1 ECURIA E NUMRIT TË AUTOVETURAVE ELEKTRIKE, 2020–2025

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor. Llogaritje INSTAT

Të dhënat bazohen në inventarin e mjeteve rrugore sipas gjendjes më 31 dhjetor të çdo viti.

Shënim për përdoruesit:

Të dhënat e detajuara vjetore janë të disponueshme në faqen zyrtare të INSTAT: [Karakteristikat e mjeteve rrugore](#)

Metodologjia

Qëllimi i këtij publikimi është paraqitja e treguesve mbi karakteristikat e mjeteve të transportit rrugor në nivel sa më të detajuar si: mjete rrugore sipas llojit, mjete rrugore sipas qarqeve, mjete rrugore sipas kambios, mjete rrugore sipas markës, mjete rrugore sipas lëndës djegëse, autoveturat sipas vitit të prodhimit dhe autoveturat sipas vëllimit motorik.

Në detajimin e autoveturave sipas lëndës djegëse, në grupin "të tjera hybride" janë përfshirë kategoritë "Benzinë + Gaz + Elektrike", "Benzinë + Elektrik + Hybrid", "Naftë + Gaz", "Naftë + Elektrik + Hybrid".

Përkufizime

Autobus – Mjet motorik i destinuar për transportin e pasagjerëve, me më shumë se 9 vende, përfshirë vendin e drejtuesit.

Autoveturë – Mjet motorik i destinuar për transportin e pasagjerëve me jo më shumë se 9 vende, përfshirë vendin e drejtuesit.

Autovetura për 1.000 banorë – Tregues që paraqet numrin e autoveturave për çdo 1.000 banorë, i llogaritur duke përdorur inventarin e autoveturave sipas gjendjes më 31 dhjetor dhe popullsinë rezidente mesatare të vitit referues.

Automjete për përdorim të veçantë (APV) – Mjete motorike të pajisura në mënyrë të përhershme me pajisje ose mekanizma të veçantë për kryerjen e funksioneve specifike.

Automjete për transport të përzier (ATP) – Mjete motorike të projektuara për transportin e njëkohshëm të personave dhe mallrave, me peshë maksimale të autorizuar deri në 3,5 ton (ose deri në 4,5 ton për automjetet elektrike) dhe me kapacitet maksimal prej 9 vendesh, përfshirë vendin e drejtuesit.

Automjete për transport të veçantë (ATV) – Mjete të projektuara për transportin e mallrave ose pasagjerëve në kushte të veçanta, sipas klasifikimit të regjistrimit administrativ.

CC (cm³) – Njësia matëse e vëllimit të motorit, e shprehur në centimetra kub.

Ciklomotor – Mjet motorik me dy, tre ose katër rrota, me karakteristika teknike që e klasifikojnë në kategorinë e ciklomotorëve sipas legjislacionit në fuqi.

Gjysmërimorkio – Mjet transporti pa fuqi motorike, i destinuar për transportin e mallrave ose pasagjerëve, që përdoret së bashku me një tërheqës.

Inventari i mjeteve rrugore – Numri i mjeteve rrugore të regjistruara sipas gjendjes në datën 31 dhjetor të vitit referues.

Kamion – Mjet motorik i destinuar për transportin e mallrave.

Lënda djegëse – Burimi kryesor i energjisë që përdoret për funksionimin e motorit të mjetit, sipas klasifikimit të regjistrimit administrativ të DPSHTRR-së.

Makinë bujqësore – Mjet motorik i destinuar për përdorim në bujqësi dhe pylltari.

Motokarro – Mjet motorik me tri rrota, i destinuar për transportin e mallrave.

Tërheqës – Mjet motorik i destinuar vetëm për tërheqjen e rimorkiove ose gjysmërimorkiove.

.